




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4958/14</u>
Nr. f. faq. Broj. stranica <u>02</u>	Data Datum <u>23-12-2014</u>
Nr. pages	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3760/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Faredin Sylejmani, zyrtar i prokurimit në Spitalin Regjional të Gjilanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi qe nuk ushtron me funksion ne biznesin privatë.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3760/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Faredin Sylejmani, zyrtar i prokurimit në Spitalin Regjional të Gjilanit.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i prokurimit në Spitalin Regjional të Gjilanit, është duke ushtruar edhe funksion ne veprimtari private pra si person i autorizuar ne një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 31.10.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z. Faredin Sylejmani, zyrtar i prokurimit në Spitalin Regjional të Gjilanit, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë në takimin që është mbajtur me z. Sylejmani, me datën 17.11.2014 e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, ndërsa z. Sylejmani është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të tërhiqet nga personi i autorizuar në biznesin privatë

Me datën 15.12.2014, z. Faredin Sylejmani, ka sjell në Agjenci dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara dhe se në biznesin privat me nr biznesi 80089368 –dhe emër N.T.H. “Albenisi” zyrtari në fjalë nuk figuron si person i autorizuar në këtë kompani pasi që ka emëruar një person të autorizuar në këtë biznes.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik z. Faredin Sylejmani, me largimin e tij nga funksioni i personit të autorizuar në bizneset privatea N.T.H. “Albenisi” ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

